



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 80, datë 27.07.2020

“PËR

**MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I
BLLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND, NGA FONDI I
KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË TIRANË, PËR PERIUdhËN 1-30
QERSHOR 2020”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreut IV, pikat 2, 3 dhe 6, të vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Vendimit nr. 157, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, të ndryshuar, Vendimit nr. 3, datë 05.02.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit, për përdorimin e fondit të kushtëzuar ose fondit të buxhetit vendor, mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind për vitin 2020”, si dhe referuar Raportit Përmbledhës nr. 23826 prot., datë 16.07.2020, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së familjeve përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind nga buxheti i Bashkisë Tiranë, për periudhën 1-30 Qershor 2020, sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e listës së familjeve përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind nga fondi i kushtëzuar për periudhën 1-30 Qershor 2020, sipas tabelës nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Efektet financiare sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, do të mbulohen nga fondi i vënë në dispozicion nga fondi i kushtëzuar dhe buxheti vendor për programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind.
4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

TONI GOGU

Tabela nr. 1

Përmbledhëse e Njësive Administrative për përdorimin e fondit nga programi i bllok-ndihmës ekonomike me buxhetin vendor Qershor 2020.

Nr	Njësia Administrative	Masa e ndihmës ekonomike	
		Nr. Familjeve	Lekë
1	Njësia 1	19	44.720
2	Njësia 2	20	44.600
3	Njësia 3	1	3.060
4	Njësia 4	11	24.720
5	Njësia 5	20	62.640
6	Njësia 6	15	37.480
7	Njësia 7	12	29.860
8	Njësia 8	10	24.360
9	Njësia 9	26	67.800
10	Njësia 10	7	12.600
11	Njësia 11	10	30.660
12	Njësia Petrele	1	3.600
13	Njësia Farke	0	0
14	Njësia Dajt	0	0
15	Njësia Zall-bastar	0	0
16	Njësia Bërzhitë	5	11.060
17	Njësia Krrabë	8	21.420
18	Njësia Baldushk	7	30.460
19	Njësia Shëngjergj	4	9.360
20	Njësia Vaqarr	6	16.000
21	Njësia Kashar	12	32.940
22	Njësia Pezë	1	8.000
23	Njësia Ndroq	7	22.860
24	Njësia Zall-Herr	4	23.000
	TOTALI	206	561.200

Tabela nr. 2

Përmbledhëse e Njësive Administrative për përdorimin e fondit të kushtëzuar deri në 6 % për muajin Qershor 2020.

Nr	Njësia Administrative	Masa e ndihmës ekonomike	
		Nr. Familjeve	Lekë
1	Njësia 1	0	0
2	Njësia 2	7	16.380
3	Njësia 3	4	11.160
4	Njësia 4	9	23.300
5	Njësia 5	7	14.660
6	Njësia 6	15	38.220
7	Njësia 7	9	23.300
8	Njësia 8	11	32.460
9	Njësia 9	9	25.720
10	Njësia 10	8	16.560
11	Njësia 11	17	38.160
12	Njësia Petrelë	0	0
13	Njësia Farkë	0	0
14	Njësia Dajt	6	18.180
15	Njësia Zall-bastar	11	27.900
16	Njeëia Bërzhitë	0	0
17	Njësia Krrabë	0	0
18	Njësia Baldushk	0	0
19	Njësia Shëngjergj	6	14.580
20	Njësia Vaqarr	6	16.260
21	Njësia Kashar	14	38.700
22	Njësia Pezë	4	13.680
23	Njësia Ndroq	5	11.400
24	Njësia Zall-herr	0	0
	TOTALI	148	380.620